



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Kryetari i Komunës
Predsjednik Opštine
Nr./Br. 01-056/24-736/1

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167

kryetari@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 05.02. 2025. godine

Në bazë të nenit 99 paragrafi 1 pika 22 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale”, nr. 024/29, 005/20, 051/22 dhe 055/22), nenit 3 të Vendimit mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OJQ-ve në grupet punuese (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale”, nr. 020/20) në lidhje me nenin 16 të Ligjit për Sportin (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 044/18, 123/21), kryetari i komunës shpall:

THIRRJE PUBLIKE

PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE PËR PROPOZIMIN E KANDIDATIT/ES PËR ANËTAR/E TË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË SPORTIT

Njoftohen organizatat joqeveritare të regjistruara në Mal të Zi me seli në Komunën e Tuzit, që të propozojnë përfaqësuesin/en për anëtar/e të grupit punues për hartimin e **Strategjisë së Zhvillimit të Sportit në nivel lokal.**

Organizata joqeveritare mund të propozojë një kandidat për përfaqësues në grupin punues nëse:

- është e regjistruar në regjistrin e organizatave joqeveritare para shpalljes së kësaj thirrjeje publike;
- në Statutin e saj ka përcaktuar veprimtaritë dhe objektivat në fushat që kanë lidhje me aktin që përgatit grupi punues;
- në tre vitet e fundit, në fushën për të cilën grupi punues përgatit aktin, ka realizuar një projekt, ka hartuar një dokument, ka organizuar një tubim apo ka kryer një hulumtim të fokusuar në përmirësimin e gjendjes në atë fushë;
- i ka dorëzuar organit tatimor raportin për vitin fiskal të kaluar (dëshmi mbi dorëzimin e bilancit të gjendjes dhe suksesit ose numrin e deklaratës, nëse raporti është dorëzuar në formë elektronike);
- në organin e saj drejtues nuk ka anëtarë të organeve të partive politike, funksionarë publikë, persona drejtues apo zyrtarë shtetërorë e lokalë;
- është e regjistruar si organizatë joqeveritare të paktën një vit para shpalljes së kësaj thirrjeje publike.

Përfaqësuesi i organizatës joqeveritare mund të jetë personi që:

- ka vendbanim në territorin e Komunës së Tuzit;
- në tre vitet e fundit, në fushën për të cilën grupi punues përgatit aktin, ka marrë pjesë në realizimin e një projekti, hartimin e një dokumenti apo kryerjen e një hulumtimi të fokusuar në përmirësimin e gjendjes në atë fushë;
- nuk është anëtar i organeve të partive politike, funksionar publik, zyrtar shtetëror apo lokal.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojë organizata joqeveritare:

- kopje të vendimit të regjistrimit në organin kompetent;
- kopje të Statutit të organizatës joqeveritare;

- deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vëlosur nga organizata joqeveritare që vërteton se në tre vitet e fundit ka realizuar një projekt, hartuar një dokument, organizuar një tubim apo kryer një hulumtim në fushën përkatëse, së bashku me dëshmitë përkatëse;
- dëshmi mbi dorëzimin e bilancit të gjendjes dhe suksesit për vitin e kaluar tek organi tatimor kompetent;
- deklaratë të përfaqësuesit të autorizuar të organizatës joqeveritare që vërteton se në organin drejtues të organizatës nuk ka anëtarë të partive politike, funksionarë publikë apo zyrtarë shtetërorë/lokalë;
- kopje të letërnjoftimit ose dokumentit tjetër të vlefshëm që vërteton identitetin e kandidatit për përfaqësues;
- biografinë e kandidatit për përfaqësues;
- deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vëlosur nga organizata joqeveritare që vërteton se kandidati i propozuar ka marrë pjesë në tre vitet e fundit në realizimin e projekteve, hartimin e dokumenteve apo hulumtimeve në fushën përkatëse;
- deklaratë të kandidatit të propozuar që vërteton se ai/ajo nuk është anëtar i organeve të partive politike, funksionar publik apo zyrtar shtetëror/lokal;
- deklaratë të kandidatit të propozuar për pranimin e propozimit të organizatës joqeveritare për anëtarësim në grupin punues.

Dokumentacioni për propozimin e kandidatit për anëtar të grupit punues duhet të dorëzohet pranë Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale të Komunës së Tuzit, në një zarf të mbyllur me mbishkrimin **“Propozimi i kandidatit” për anëtar/e të grupit punues për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Sportit në nivel lokal**, përmes arkivit të Komunës së Tuzit ose me postë.

Formulari i aplikimit mund të merret direkt në arkivin e Komunës së Tuzit ose në faqen zyrtare të internetit www.tuzi.org.me.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është deri më 13.02.2025

KRYETARI,

Lindon Gjellaj



Lindon Gjellaj